



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 858/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Zyhdi Haziri kryesues, Rrustem Thaqi dhe Adnan Konushevcu anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Suharekës, Ilir Sopaj nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Komunën e Suharekës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 të datës 03.11.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET** i pabazuar apeli Anr.858/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Suharekës, Ilir Sopaj, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Suharekë, kundër vendimit Nr.2948/2021 të datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për Kuvendin Komunal, për shpalljen e rezultatit përfundimtar, me të cilën ka kërkuar që të rinumërohen votat në vendvotimet nr. 2405A/01R, 2405A/02R dhe 2405A/04R.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin me datën 04.11.2021 nga anëtari për Kuvend Komunal në Komunën e Suharekës, Ilir Sopaj nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Komunën e Suharekës me nr. të listës 23, me të cilën pretendon se në vendvotimet 2405A/01R, 2405A/02R dhe 2405A/04R ka mungesë të votave sipas deklaratave të familjarëve të tij me të cilën e kanë votuar. Më tutje thekson se në këto tri vendvotime në bazë të dëshmimeve të Fletave të regjistrimit të votave nga vëzhguesit e partisë ka marrë 10 vota ndërsa në Formularët e Regjistrimit të Kandidatëve të publikuar nga KQZ del se në këto tri vendvotime ka vetëm një votë në VV.2405A/02R.

Andaj përmes apelit ka kërkuar që të bëhet rinumërimi në Vendvotimet 2405A/01R, 2405A/02R dhe 2405A/04R.

Si provë ka bashkangjitur nënshkrimet e votuesve të cilët kanë deklaruar se e kanë votuar në këto vendvotime.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi apelin, vlerësoi se:

**Apeli është i pabazuar**

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtuesi i apelit kërkon që të rinumërohen në vendvotimet 2405A/01R, 2405A/02R dhe 2405A/04R në Komunën e Suharekës.

Paneli, vlerëson se parashtuesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara për mungesë të votave, nga lista e bashkangjitur me disa nënshkrime nga parashtuesi i apelit nuk vërteton rrethana se nënshkruesit në listën e bashkangjitur në ankesës nuk janë deklaruar se kanë votuar dhe ku kanë votuar, lista e tyre është vetëm me emrat dhe ditëlindjet e tyre, numrat personal, nënshkrimet pa kurrfarë teksti të deklaramit e tyre, për çka te bej ajo liste pretendimet në apel, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime të votave, për faktin se thëniet e saj nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë të imagjinuara sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit dhe mungesë të votave, andaj pala ankuese nuk i ka argumentuar shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Ilir Sopaj, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), nuk është i bazuar me asnjë dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

**Anr.858/2021 më datë 06.11.2021**



**Kryesues i Panelit**  
**Zynda Ilaziri**

***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.***